



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:120628

Datë: 30.09.2019

Numri i dokumentit: 00541571

P.nr.639/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren Fitore Daci si dhe zyrtarin ligjor Burim Haxhidema, në çështjen penale kundër të pandehurit H.A nga, për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 402 par.2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1002-4/19 të datës 07.06.2019, në praninë e prokurores së shtetit Albana Parduzi, si dhe të pandehurit H.A, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më dt.18.09.2019, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

H.A i lindur me, nga i ati N.. dhe nëna S....nga, i papunë, ka të kryer shkollën e ulët, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, shfrytëzues i asistencës sociale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Se më dt.30.04.2019, rreth orës 11:30 në Objektin e ... i ka sulmuar, personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe atë zyrtarët policor Rr. P dhe N.T, në atë mënyrë që i pandehuri fillimisht i kishte fyer, sharë, ofenduar zyrtarët policor duke tentuar të hy me forcë në objektin e komunës, ku më pastaj i njëjti ka marrë një pllakë betoni (kubëz) dhe ka gjuajtur në drejtim të zyrtarëve policor por nuk kishin pësuar lëndime.

me këtë ka kryer veprën penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 402 par.2 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,41,42,49,50,51,52,70,71,72, nenit 402 par.2 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453,463, të KPPRK-së, të pandehurin e

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti në qoftë se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk do të kryej vepër të re penale.

Të dëmtuarit N.T me vendbanim në..... dhe Rr.P me vendbanim në Rrugën ”.....”, Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest juridiko civil.

Konform nenit 453 par.4 të KPPRK-së, gjykata e liron të pandehurin H.A nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit-familjes së tij, pasi që është i gjendjes shumë të rëndë ekonomike.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën P.II.nr.1002-4/19 të datës 07.06.2019 ka ngarkuar të pandehurin H.A nga....., për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 402 par.2 të KPRK-së, duke propozuar që të pandehurin të e shpall fajtor dhe të i shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 18.09.2019 në të cilën shqyrtim gjyqësor: i pandehuri e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza dhe është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, pendohet për veprën penale të cilën e ka kryer, premtion gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryhej veprime te tilla, i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të i shqipton një dënim sa më të butë.

Prokurorja e Shtetit Albana Parduza duke shprehur mendimin e saj përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, duke i propozuar Gjykatës që të njëjtin të e shpall fajtor dhe të i shqipton dënimin e merituar.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendes.

Me qenë se i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtarja konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 402 par.2 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 71 dhe 72 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, nuk është vërtetuar se kanë qenë të dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, e që këto rrethana i ndërlidhi me rrethanat personale, të gjendjes së rëndë ekonomike, në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurve dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Konform nenit 453 par.4 të KPPRK-së, gjykata e liron të pandehurin H.A nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit-familjes së tij, pasi që është i gjendjes shumë të rëndë ekonomike.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL

P.nr.639/19 datë 18.09.2019

Zyrtar ligjor,

Gjyqtarja

Burim Haxhidema

Fitore Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.